

L'UNIVERSITÉ UKSHIN HOTI PRIZREN / AMBASSADE DE FRANCE  
UNIVERSITETI UKSHIN HOTI PRIZREN/ AMBASADA E FRANCËS NË KOSOVË  
ACCORD DE PARTENARIAT  
MARRËVESHJE PËR PARTNERITET

*Préambule- Parathënie :*

L'Université UKSHIN HOTI PRIZREN [UPZ] et l'Ambassade France au Kosovo [AFK] se sont rencontrées à plusieurs reprises en 2022. L'objectif était de mieux se connaître (infrastructures, moyens humains, compétences respectives...), afin de mettre en œuvre une relation privilégiée à engager dès la semaine de la Francophonie 2023, notamment entre le Service de Coopération et d'Action Culturelle [SCAC] d'une part, et avec la participation de l'Alliance Française de Pristina [AFP] et l'Université d'autre part.

Universiteti UKSHIN HOTI PRIZREN [UPZ] dhe Ambasada e Francës në Kosovë [AFK] janë takuar disa herë gjatë vitit 2022. Këto takime kishin të bënin me njohjen e ndërsjellë (infrastrukturën, burimet njerëzore, aftësitë përkatëse, etj.), me qëllim të ndërtimit të një marrëdhënie të privilegjuar duke filluar nga Java e Frankofonisë 2023, veçanërisht ndërmjet Departamentit për Bashkëpunim dhe Veprimtari Kulturorë [SCAC] nga njëra anë, si dhe me pjesëmarrjen e Aleancës franceze të Prishtinës [AFP] dhe Universiteti UPZ nga ana tjetër.

A la suite de plusieurs entrevues coordonnées par Madame la Doyenne Sortante de la Faculté de Philologie de l'Université de Prizren, il apparait aux deux parties, qu'un accord cadre, fondant et organisant cette relation privilégiée, permettrait de :

Pas disa shkëmbimeve të koordinuara nga ish Dekanja e Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prizrenit, për të dyja palët duket se një marrëveshje kornizë, bazë e kësaj marrëdhënieje të privilegjuar, do ta bënte të mundur:

- 1. **Proposer**, de manière générale, et au sein de l'université une 'présence française' au cœur de celle-ci, offrant ainsi aux enseignants, étudiants et visiteurs, une vitrine ouverte sur le modèle culturel, éducatif et républicain français,
- 1. **Propozimin**, në përgjithësi, dhe brenda Universiteti, të një 'pranije franceze' në hapësirën e tij, duke u ofruar kështu mësimdhënësve, studentëve dhe vizitorëve një vitrinë të hapur të modelit kulturor, arsimor dhe republikan francez,
- 2. **Ouvrir** un centre de ressources et de rencontres, soit un Espace « France » animé par le SCAC, l'Alliance Française [AF] et l'Université de Prizren. Durant les sessions en présentiel, l'accueil d'étudiants et enseignants sera évidemment prioritaire, mais non exclusif.

*Nb. Une convention spécifique d'objectifs et de moyens sera signée entre [UPZ] et l'AF. Visée par l'ambassade elle sera pensée de telle sorte qu'elle garantisse cohérence, efficacité, efficacité au bénéfice d'une communication optimale entre les trois entités. Il sera également joint une annexe complète présentant en détails un Espace France*

- 2. **Hapjen** e një qendre burimesh dhe takimesh ose nje hapësire « France » e cila do të animohet nga SCAC dhe Aleanca Franceze [AF] dhe Universiteti i Prizrenit. Gjatë seancave në prezencë, do t'i ipet padyshim prioritet mirëpritjes së studentëve dhe mësimit, por jo vetëm.

*Nb. Një marrëveshje specifike mbi qëllimet dhe burimet do të nënshkruhet ndërmjet [UPZ] dhe AF. E mbikqyrur nga Ambasada, ajo do të dizajnohet në atë mënyrë që të garantojë qëndrueshmëri dhe efikasitet në dobi të komunikimit optimal midis tre palëve. Një shtojcë e plotë do t'i bashkëngjitet gjithashtu duke paraqitur në detaje një Espace France.*

- 3. **Associer** l'université aux activités culturelles (Création contemporaine, cinéma, arts plastiques, musique, gastronomie, conférences, master classes) soutenues par l'ambassade de France.
- 3. **Asociimin** e Universitetit me aktivitete kulturore (krijimtari bashkëkohore, kinema, arte pamore, muzikë, gastronomi, konferenca, master klasa) të mbështetura nga Ambasada Franceze.
- 4. **S'associer** lorsque l'opportunité se présente, à des consortiums européens dans le cadre de dépôts de projets l'Union européenne (H2020 / Horizon Europe, Europe Créative).
- 4. **Asociimin**, në momentin kur të krijohet mundësia, në konsorciume evropiane në kuadër të aplikimeve të projekteve të Bashkimit Evropian (H2020 / Horizon Europe, Créative Europe).
- 

... Afin de réaliser ces objectifs, les deux parties conviennent les articles suivants ...

... Për të arritur këto qëllime, të dy palët pajtohen për nenet e mëposhtme ...

## ARTICLE 1

### Gouvernance :

La coordination technique et organisationnelle du partenariat sera assurée par un comité représentant l' [UPZ], et l' [AFK]. Il s'agit du 'Comité de Coordination'.

Ce comité composé d'un membre par entité pour ses décisions, et de quatre membres au total (deux par entité), est animé par une personne désignée par le recteur et le COCAC.

Le suivi stratégique de l'accord relève du 'Comité de Pilotage'. Il est présidé, dès la signature de l'accord, par L'Ambassadeur de France et le Recteur de l'Université. Le Comité de Pilotage peut intégrer, plusieurs vice-présidentes et vice-présidents de l'Université, en parité avec les représentants du Ministère des Affaires étrangères français désignés par le Chef de la Mission Diplomatique française au Kosovo. Le Comité de Pilotage se réunit **une fois par an**.

## NENI 1

### Qeverisja :

Koordinimi teknik dhe organizativ i partneritetit do të udhëhiqet nga një komitet —me përfaqësues nga [UPZ], [AFK] Ky organ është "**Komiteti Koordinues**".

Ky komitet, i përbërë nga një anëtar për njësi për vendimmarrje, dhe nga katër anëtarë në total (dy për njësi), kryesohet nga nje person i emeruar nga Rektori dhe Këshilltari për bashkëpunim dhe veprimtari kulturore.

Monitorimi strategjik i marrëveshjes është përgjegjësi e "**Komiteti i Pilotimit**". Ky komitet udhëhiqet, sapo të nënshkruhet marrëveshja, nga Ambasadori i Francës dhe Rektori i Universitetit. Komiteti i Pilotimit mund të përfshijë disa prorektor/e të Universitetit, në numër të barabartë me përfaqësuesit e Ministrisë Franceze të Punëve të Jashtme të emëruar nga Shefi i Misionit Diplomatik Francez në Kosovë. Komiteti i pilotimit mbledhet **një herë në vit**.

## ARTICLE 2

### Infrastructures :

Afin de poursuivre au mieux l'ensemble des quatre objectifs convenus en préambule, [UPZ] met à disposition de ses partenaires :

**[AFK] et [AFP]:** L'espace choisi ensemble, et que l'[AFK] et [AFP] cogèreront conformément aux éléments mentionnés en préambule. Cette cogestion se déroulera dans le respect des accords ayant trait exclusivement à ce partenariat [France / UPZ], signés par deux des trois parties au minimum (accord(s) visé(s) par le 3<sup>e</sup> pour une information correctement partagée).

**[AFP]:** Des salles de cours ou de conférences lorsqu'un projet pédagogique convenu en Comité de Coordination aura été programmé.

**[AFK]:** Plusieurs salles seront mises à disposition par l'[UPZ] lorsqu'une activité artistique ou culturelle, ou un ensemble d'activités artistiques et culturelles auront été convenues et programmée en Comité de Coordination.

## NENI 2

### Infrastruktura :

Për të arritur sa më mirë të katër qëllimet e prezantuara në parathënie, [UPZ] vë në dispozicion të partnerëve të saj:

**[AFK] dhe AFP :** Hapësirën e përzgjedhur së bashku, dhe të cilën [AFK] dhe [AFP] do të bashkëmenaxhojnë në përputhje me elementet e përmendura në preambulë. Ky bashkëmenaxhim do të bëhet në përputhje me marrëveshjet e lidhura ekskluzivisht në kuadër të këtij partneriti [Francë / UPZ], të nënshkruara nga të paktën dy nga tre palët (me informimin e palës së tretë, kjo për çështje të komunikimit korrekt ndërmjet palëve).

**[AFP]:** Klasat ose sallat e konferencave për projekte pedagogjike të paraparë dhe mbështetur nga Komiteti Koordinues.

**[AFK]:** Disa salla do të vihen në dispozicion nga [UPZ] kur një aktivitet artistik ose kulturor, ose një grup aktiviteteve artistike dhe kulturore të jenë dakorduar dhe planifikuar nga Komiteti Koordinues.

## ARTICLE 3

### Réciprocité de services :

Hors projet au format de ceux envisagés en objectif 4 (Projets européens, projets EUNIC, projets financés ou cofinancés par un ou plusieurs tiers au bénéfice d'un consortium européen impliquant [UPZ], [AFK] ou AFP), les trois parties veilleront à établir des mémoires, lors des Comités de Pilotage, établissant la balance des apports de [UPZ] d'une part, et de [AFK]§[AFP] d'autre part.

Il importe en effet d'objectiver les moyens mobilisés de part et d'autre afin de démontrer que la volonté initialement exprimées par les parties, reste égale durant toute la durée du partenariat.

### A°. Valorisation des moyens humains et des ressources techniques :

[UPZ] met à disposition des infrastructures utilisées, pour certaines, de façon permanente (l'Espace France), pour d'autres temporaires (salles). L'ensemble constitue un apport matériel et humain significatif, qui peut être valorisé dans un mémoire financier/logistique/humain.

De même, l'[AFK] contribue au déploiement des projets, en ingénierie de programmation, dans les permanences (présentiel) aux rendez-vous (conseils et interventions *in situ*), et enfin en ressources techniques et documentaires au sein de l'Espace France, ainsi qu'un processus d'autonomisation (formation française jusqu'au niveau B1) et de préparation au conseil adapté aux étudiants sera mis en place afin de garantir à l'Espace France une permanence

Enfin l'[AFP] mobilisera également du personnel (permanences, gestion des ressources et des adhésions, espace Campus France), dans les premiers mois du projet du personnel étant entendu d'accueil raisonnable et de haut niveau.

**B°. Apports financiers :**

L'[AFP] développera également au sein d'[UPZ], des modules de formation, dès lors qu'ils sont approuvés en Comité de coordination. Il conviendra d'établir entre [UPZ] et [AFP] le coût net de ces formations, en ne retenant que les charges variables liées à l'emploi de vacataires recrutés afin d'animer ces cours. En effet, les coûts structurels de part et d'autre font l'objet des mémoires évoqués dans le paragraphe A°.

**NENI 3**

**Reciprociteti i shërbimeve:**

Duke përjashtuar projektet në formatin e atyre të parashikuara në Nenin 4 (projekte evropiane, projekte të EUNIC, projekte të financuara ose bashkëfinancuara nga një ose më shumë palë të treta për përfitimin e një konsorciumi evropian që përfshin [UPZ], [AFK] ose AFP), të tre palët do të jenë të kujdeshme në hartimin e përmbledhjeve, gjatë Komiteteve Pilotuese, duke paraqitur bilancin e kontributeve të [UPZ] nga njëra anë, dhe të [AFK]- [AFP] nga ana tjetër.

Është me të vërtetë e rëndësishme qartësimi i mjeteve të mobilizuara nga të dyja palët në mënyrë që të demonstron se vullneti i shprehur fillimisht nga to mbetet i barabartë gjatë gjithë kohëzgjatjes së partneritetit.

**A°. Vlerësimi burimeve njerëzore dhe teknike:**

[UPZ] siguron infrastrukturë e cila mund të përdoret, për disa nga to, në mënyrë të përhershme (Hapësira "France"), për të tjera të përkohshme (salla). Kjo tërësi përbën një kontribut domethënës material dhe njerëzor, i cili mund të vlerësohet në një përmbledhje financiare / logjistike / njerëzore.

Në mënyrë të ngjashme, [AFK] kontribuon në realizimin e projekteve, në inxhinierinë e programimit, në kujdestari, në takime (këshilla dhe intervenime *in situ*), dhe në fund në burimet teknike dhe dokumentare brenda Hapësirës "France" si dhe një proces fuqizimi (trajtime në gjuhë frenge deri në nivelin B1) dhe përgatitje për këshillim të përshtatur për studentët.

Së fundi, [AFP] gjithashtu mobilizon stafin (kujdestaria, menaxhimi i burimeve dhe anëtarësimeve, hapësira e Campus France) në muajt e parë të projektit të stafit, duke u rezervuar pritje të arsyeshme dhe të nivelit të lartë.

**B°. Kontributet financiare:**

[AFP] do të zhvillojë module trajnimi brenda [UPZ], pas miratimit nga Komiteti Koordinues. Kostoja neto e këtyre kurseve të trajnimit duhet të përcaktohet ndërmjet [UPZ] dhe [AFP], duke ruajtur vetëm kostot e ndryshueshme që lidhen me punësimin e stafit të përkohshëm të rekrutuar për të drejtuar këto kurse. Në të vërtetë, kostot strukturore në të dy anët janë subjekt i raporteve të përmendura në paragrafin A°.

**ARTICLE 4**

### **Projets européens et internationaux, appels à propositions :**

Le présent accord n'exclut pas les parties signataires de s'associer dans le cadre de consortiums européens. Le but est de convenir d'une doctrine d'emploi concertée de dépôts de dossiers à l'Union européenne ou auprès d'organismes associés à celle-ci, voire auprès de toute autre organisation supranationale ou internationale, à la condition que celle-ci soit reconnue par la France et le Kosovo.

L'[AFP] peut participer à cette dynamique, selon les opportunités d'appels à propositions qui se présentent, en fonction des éligibilités requises dans ces appels, si l'[AFK] est partie prenante du projet en voie de dépôt.

L'[AFP] pourra étudier avec [UPZ], l'opportunité de répondre à des appels à propositions émanant du Ministère des Affaires Etrangères français ou d'un de ses organismes associés (Institut français), et ceci dans le but de renforcer et développer la qualité de ses activités pédagogiques.

Ce dépôt devra toutefois faire l'objet d'une demande d'avis auprès de l'[AFK].

Dans le cas d'une même démarche, auprès cette fois d'un Ministère kosovar ou d'un organisme associé, [UPZ] et [AFP] procéderont à une information formelle auprès de l'[AFK].

### **NENI 4**

#### **Projekte evropiane dhe ndërkombëtare, thirrje për propozime:**

Kjo marrëveshje nuk përjashton bashkimin e forcave të paleve nenshkruese brenda kuadrit të konsorciumeve evropiane. Qëllimi është të bihet dakord mbi një doktrinë të përdorimit të bashkërenduar të aplikimit në Bashkimin Evropian ose me organet e lidhura me të, apo edhe me ndonjë organizatë tjetër suprancionale ose ndërkombëtare, me kusht që këto të fundit të njihen nga Franca dhe Kosova.

[AFP] mund të marrë pjesë në këtë dinamikë, në varësi të mundësive që vijnë nga thirrja për propozime, dhe të eligjibilitetit të kërkuar në këto thirrje, nëse [AFK] është një palë e interesuar në projektin që po paraqitet.

[AFP] do të jetë në gjendje të studiojë me [UPZ], mundësinë për t'iu përgjigjur thirrjeve për propozime nga Ministria Franceze e Punëve të Jashtme ose një prej organizatave të varura nga kjo e fundit (Instituti Francez), me qëllim të forcimit dhe zhvillimit të cilësisë së aktiviteteve të saj pedagogjike.

Sidoqoftë, ky aplikim do të duhet të jetë subjekt i një kërkesë për opinion nga [AFK].

Në rast të së njëjtës qasje, këtë herë me një Ministri Kosovare ose një organ të asociuar, [UPZ] dhe [AFP] do të njoftojnë zyrtarisht [AFK]-në.

### **ARTICLE 5**

#### **Adhésion à la carte de membre de l'AFP :**

L' [AFP] et l' [AFK], qui par ailleurs soutient l'Alliance dans la mise en œuvre de son programme d'adhésion pour tout bénéficiaire de ses services et produits pédagogiques (via l'achat de la carte fixé à 5€), souhaitent encourager la démarche d'adhésion au sein d'[UPZ].

Ainsi, dans le cadre des programmes de formation que l'[AFP] développera au sein d'[UPZ], programmes qui auront été présentés et visés par le Comité de coordination, les participants, qu'ils soient enseignants ou étudiants, deviendront titulaires de la carte de membre de l'[AFP]. Celle-ci est renouvelable du cycle de validité de toutes les cartes membres de l'ensemble du Kosovo et qui est fixé au 31 août de chaque année.

Cette carte confère par ailleurs à son titulaire, des informations 'en avant-première' et un pass-privilege pour toute manifestation culturelle organisée par le SCAC, ou avec le soutien de l'Ambassade de France, quel que soit l'endroit où celle-ci est présentée au Kosovo.

*Nb. Toute personne, non titulaire de la carte en vigueur de membre de l'[AFP], pourra se voir refuser l'entrée de l'Espace France par ses référents. La liste des personnes de l'Ambassade de France ou de l'Alliance française de Pristina, habilitées à entrer dans les locaux d'[UPZ], afin de mettre en œuvre cette présente convention, sera communiquée à l'UPZ par le SCAC de l'[AFK].*

## NENI 5

### **Anëtarësimi dhe marrja e kartelës në AFP:**

[AFP] dhe [AFK], e cila gjithashtu mbështet Aleancën në zbatimin e programit të saj të anëtarësimit për çdo përfitues të shërbimeve dhe produkteve të saj edukative (përmes blerjes së kartelës në shumën prej 5 €), dëshirojnë të inkurajojnë procesin e anëtarësimit brenda [UPZ].

Kështu, si pjesë e programeve të trajnimit që [AFP] do të zhvillojë brenda [UPZ], programe që do të jenë prezantuar dhe miratuar nga Komiteti Koordinues, pjesëmarrësit, qofshin mësimdhënës apo studentë, do të antarësohen në [AFP]. Kjo është e rinovueshme për ciklin e vlefshmërisë së të gjitha kartave anëtare të gjithë Kosovës dhe që fiksohet më 31 gusht të çdo viti.

Kjo kartelë gjithashtu i siguron mbajtësit të saj informacion " në parapremierë" dhe një pass privilegji për çdo ngjarje kulturore të organizuar nga SCAC, ose me mbështetjen e Ambasadës së Francës, pavarësisht se ku organizohet ajo ngjarje në Kosovë.

*Nb. Çdo personi të huaj për [UPZ], jo posedues i kartelës së anëtarit aktual [AFP], mund t'i refuzohet hyrja në [UPZ] nga agjentët e tyre, nëse ky person shkon në Universitet në bazë të kësaj marrëveshjeje, përveç nëse shoqërohet nga stafi [AFK] ose [AFP]. Lista e personave nga Ambasada e Francës ose Aleanca franceze e Prishtinës, të autorizuar për të hyrë në ambientet e [UPZ]-së, për të zbatuar këtë marrëveshje të tanishme, do t'i komunikohet Universitetit të [UPZ]-së nga SCAC-u i [AFK].*

## ARTICLE 6

### **Prolongation ou résiliation de la présente convention :**

La présente convention est renouvelable par tacite reconduction à la date anniversaire de sa signature, sauf à être résiliée par l'une des deux parties, dans le cadre du dernier Comité de Pilotage, de l'année qui précèdera la fin du présent accord.

## NENI 6

### Zgjatja ose përfundimi i kësaj marrëveshjeje:

Kjo marrëveshje mund të rinovohet me marrëveshje të heshtur në datën e përvjetorit të nënshkrimit të saj, nëse nuk nderpritet nga njëra prej dy palëve, në kuadër të Komitetit të Pilotimit të fundit, të vitit që i paraprin përfundimit të kësaj marrëveshjeje.

### **Entrée en vigueur - Hyrja në fuqi**

La présente convention de partenariat entre en vigueur à la date de sa signature par les deux parties.

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dy palët.

En cas de divergence d'interprétation entre la version française et la version albanaise du texte, la version albanaise prévaudra.

Në rast të veshtirësisë rreth interpretimit të teksit në versionin në gjuhë frënge dhe atij në gjuhë shqipe, versioni shqip merret parasysh.

Fait à Prizren 2 exemplaires, le .....2023.

Prizren, në dy ekzemplarë, më ..... 2023.

**Pour l'Université UPZ-**


**Për Universitetin UPZ,**



**M. Samedin KRRABAJ,**  
**Recteur-Rektor**

**Pour l'Ambassade**

**Për Ambasadën,**



**M. Olivier GUEROT,**  
**Ambassadeur de France au Kosovo**  
**Ambasador i Francës në Kosovë**